

HUGO BOSS

KODI I SJELLJES SË FURNITORËVE

PARATHËNIE

Kodi i sjelljes së furnitorëve i HUGO BOSS formulon standardet dhe vlerat e përgjithshme të furnitorëve të HUGO BOSS, të cilat i referohen mbi të gjitha vlerësimit dhe respektimit të etikës së biznesit, të të drejtave të njeriut, të standardeve të punës dhe ato sociale si dhe të tematikave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit. Kërkesat bazohen te deklaratat e përgjithshme e të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara (UN), te principet udhëheqëse të UN për ekonominë dhe të drejtat e njeriut, te konventat themelore të organizatës ndërkombëtare të punës (ILO) si dhe te parimet udhëheqëse të organizatës për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OECD) për ndërmarrje multinationale. Përveç kësaj merren parasysh parimet e Fashion Industry Charter for Climate Action të konventës kuadër për ndryshimet klimaterike të Kombeve të Bashkuara (UNFCCC). Kërkesat duhet të kuptohen si të drejta dhe detyrime themelore për të gjithë furnitorët e HUGO BOSS dhe të punësuarit e tyre. Furnitorët janë të detyruar, ti informojnë punonjësit e tyre në mënyrë të përshtatshme mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, të cilat rezultojnë nga kërkesat e formuluarat nga HUGO BOSS si dhe nga ligji kombëtar përkatës në fuqi.

Kodi i sjelljes së furnitorëve i HUGO BOSS formon bazën për standardet e Compliance që priten dhe duhen respektuar nga furnitorët e HUGO BOSS. Këto kërkesa paraqesin standardin minimal, që nga pikëpamja e HUGO BOSS duhet të kompensojë në rast nevoje situatën e pamjaftueshme ligjore te vendet e punësimit. **Nëse përcaktimet ligjore të një vendi ndjekin të njëjtin qëllim ashtu si edhe standardet e përcaktuara nga HUGO BOSS, atëherë aplikohet ai rregull, i cili mbron më mirë interesat e punëmarrësve dhe mjedisin.** HUGO BOSS rezervon të drejtën, të kontrollojë dhe përshtatë rregullisht respektimin e kërkesave. Përzgjedhja e llojit dhe mënyrës së kontrollit në çdo rast i mbetet HUGO BOSS. HUGO BOSS pret që të gjithë furnitorët t'ia transmetojnë kodin e sjelljes së furnitorëve të HUGO BOSS furnitorëve të tyre dhe të kontrollojnë rregullisht respektimin e standardeve të përcaktuara. Indikacionet konkrete për shkelje të standardeve të përcaktuara në zinxhirin e furnizimit i duhen raportuar menjëherë HUGO BOSS.

Në rastin e mosrespektimit të standardeve të përcaktuara, HUGO BOSS duke respektuar të gjitha rrethanat e rasteve të veçanta dhe shkallën e shkeljes, rezervon të drejtën e sanksioneve. Të gjitha kërkesat duhet të trajtohen si pjesë themelore bazë e kontratës së marrëdhënies së biznesit. Në rastin e shkeljeve të përsëritura, HUGO BOSS rezervon të drejtën e përfundimit të marrëdhënies së biznesit.

1. RESPEKTIMI I LIGJEVE DHE ETIKËS SË BIZNEZIT

HUGO BOSS pret nga të gjithë furnitorët respektimin e ligjeve përkatëse kombëtare dhe të normave ndërkombëtare në fuqi. Çdo formë e mashtrimit, korrupsionit si dhe akordimi i avantazheve jo të lejuara i të gjitha llojeve është i ndaluar. Vendimet e biznesit duhen marrë në bazë objektive dhe nuk lejohet që të mbivendosen nga interesat subjektive. HUGO BOSS pret gjithashtu, që të gjithë furnitorët, si dhe aksionarët dhe udhëheqësit e tyre, të respektojnë rregullat në fuqi të konkurrencës, pastrimit të parave, të sanksioneve dhe taksimit dhe ti detyrojnë po kështu furnitorët e tyre. Përveç kësaj HUGO BOSS pret, që furnitorët e vet të njohin zinxhirët e tyre të furnizimit, në mënyrë që në rastin e këshillave konkrete, të identifikohen sa më shpejt të jetë e mundur shkeljet në zinxhirin e furnizimit.

Përveç kësaj furnitorët janë të detyruar, që të mbrojnë me çdo mënyrë informacionet, të dhënat dhe sekretet e biznesit që i janë dhënë atyre dhe ti dorëzojnë ose ti fshijnë ato menjëherë pas përfundimit të marrëdhënies së furnizimit.

2. TË DREJTAT E NJERIUT & STANDARDET E PUNËS

Ruajtja e të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore për HUGO BOSS ka prioritetin më të lartë. Respektimi i të drejtave të njeriut të njohura ndërkombëtarisht pritet nga të gjithë furnitorët në lidhje me të gjitha aktivitetet e biznesit në fushën vetjake të ndikimit. Shkeljet nuk tolerohen nga HUGO BOSS. Furnitori ka detyrimin, që të krijojë një mekanizëm të besueshëm dhe anonim ankimimi, për ti mundësuar punonjësve raportimin e shkeljeve. Përveç kësaj, punonjësit e të gjithë furnitorëve në zinxhirin e furnizimit posedojnë të drejtën të përdorin sistemin e pavarur dhe falas të dhënies së indikacioneve të HUGO BOSS (shihni shtojcën). Të gjithë furnitorët duhet të informojnë punonjësit e tyre mbi mundësitë e përdorimit të sistemit në mënyrë të përshtatshme. Përveç kësaj HUGO BOSS i detyron furnitorët për respektimin e Human Rights Policy, e cila mund të shihet në ueb sajtin e Corporate në versionin e saj aktual dhe të vlefshëm.

2.1 GRUPET VULNERABËL

HUGO BOSS mban një përgjegjësi të veçantë për faktin, që të respektojë dhe ruajë të drejtat e njeriut dhe standardet e punës në marrëdhënien e biznesit me pjesëtarë të të ashtuquajturave grupeve vulnerabël, që janë veçanërisht për tu mbrojtur. Sidomos të drejtat e fëmijëve dhe të punonjësve të rinj, të grave, të punonjësve që shpërngulen, të popujve indigjenë dhe të atyre që punojnë nga shtëpia duhet të mbrohen. Rreziqet për këto grupe janë tepër të larta për shkak të përfaqësimit mbi-proporcional në industrinë e tekstileve. HUGO BOSS ndjek në aktivitetin e tij të biznesit një qasje të diferencuar për mbrojtjen e këtyre grupeve dhe pret nga furnitorët që edhe ato të mbrojnë të drejtat e tyre.

2.2 PUNA E FËMIJËVE

HUGO BOSS refuzon në mënyrë strikte të gjitha format e punës së fëmijëve. Prandaj furnitorëve u ndalohet rreptësishtë përdorimi i punës së fëmijëve. Përcaktimi i punës së fëmijëve orientohet te standardet e njohura në të gjithë botën të ILO. Moshë minimale për fillimin e një punë është 15 vjeç. Por parimisht punësimi nuk lejohet para përfundimit të arsimit të detyrueshëm. Rregulli me mbrojtjen më të gjerë ka përparësi. Nëse puna fillohet në moshën 18 vjeç, atëherë duhet të përmbushen detyrime të caktuara për mbrojtjen e punonjësve të rinj, të cilët bazohen te standardet ndërkombëtare dhe që janë përmbledhur në *direktivën përkatëse për trajtimin e punës së fëmijëve dhe të punës së detyrueshme të HUGO BOSS*.

2.3 POPUJT INDIGJENË

Popujt indigjenë kanë një lidhje të veçantë me një zonë ose rajon të caktuar te resurset natyrore të atjeshme. HUGO BOSS ka përgjegjësinë, të respektojë dhe të mbrojë të drejtat zakonore në terren dhe resurset natyrore të popujve indigjenë dhe i bashkësive lokale, të cilat preken ose mund të preken nga aktivitetet e biznesit të ndërmarrjes, dhe e pret këtë gjë edhe nga furnitorët e tij. Do të zhvillohen procese dhe standarde për të mbrojtur mënyrën e jetesës së popujve indigjenë dhe për të mbrojtur bashkësitë lokale dhe për të nxitur përfshirjen e tyre në proceset e vendimmarrjes.

2.4 PUNA NË SHTËPI

ILO e përcakton punën në shtëpi si çdo punë, e cila kryhet në shtëpinë e tij ose në mjedise të tjera sipas dëshirës së tij, duke përjashtuar ambientin e punës së punëdhënësit. Kjo punë kryhet kundrejt një shpërblimi dhe çon në një produkt ose një shërbim të përcaktuar nga punëdhënësi. Puna nga shtëpia mund të ketë avantazhe në raste të caktuara, për shembull nëse për shkak të detyrimeve familjare, nuk mund të ushtrohet një aktivitet tjetër.

HUGO BOSS i lejon furnitorëve të tij për pjesë të caktuara të procesit të prodhimit të përdorin punën nga shtëpia. Respektimi i të drejtave të punëmarrësve duhet të garantohet gjatë punës nga shtëpia. Nëse puna nga shtëpia aplikohet nga furnitorët vetjak, atëherë furnitorët janë të detyruar që të informojnë HUGO BOSS në lidhje me gamën dhe kohëzgjatjen.

2.5 PUNA E DETYRUESHME DHE SKLLAVËRIA MODERNE

HUGO BOSS ndjek një politikë të tolerancës zero kundrejt punës së detyrueshme, trafikimit të qenieve njerëzore dhe skllavërisë moderne. Furnitorët nuk lejohen në asnjë mënyrë të punësojnë punonjës të detyruar për të punuar, robër, skllavër, të burgosur ose punonjës të tjerë jo të lirë. Të gjithë punonjësve i duhet garantuar e drejta, që të largohen nga vendi i tyre i punës si dhe nga terreni i ndërmarrjes. Nëse nga furnitori vendosen në dispozicion mjedise si p.sh. strehim, atëherë në çdo moment duhet të jetë garantuar liria e lëvizjes së punonjësve, të cilët përdorin një mjedis të tillë. Të gjithë punonjëset e furnitorëve të HUGO BOSS duhet të posedojnë të drejtën, të zgjedhin sipas dëshirës llojin dhe mënyrën e punësimit, që ato kryejnë dhe të prishin marrëdhënien e punës në çdo moment duke respektuar afatet ligjore të përshtatshme. Kufizimet e lirive të punëmarrësve nuk janë të lejuara në asnjë moment. Mbajtja e depozitave ose e dokumenteve të identifikimit ose veprime të tjera të ngjashme nga ana e punëdhënësit nuk janë të lejuara.

2.6 PUNËSIMI PËRMES PALËVE TË TRETA

Nëse ngarkohet një palë e tretë me punësimin e punonjësve, furnitori ka detyrimin të kontrollojë, nëse praktikat e tij janë në përputhje me kodin e sjelljes së furnitorëve të HUGO BOSS. Në asnjë rast nuk lejohet që shpenzimet për përdorimin e palëve të treta ti transferohen punëmarrësve.

Sidomos punësimi i punonjësve që shpërngulen nga palë të treta ka nevojë për shumë kujdes dhe kontroll të proceseve nga ana e furnitorëve. Duhet të garantohet që kushtet e punësimit të komunikohen në mënyrë të kuptueshme dhe transparente dhe punonjësit që shpërngulen të njohin të drejtat e tyre. Me kërkesë të HUGO BOSS duhet të jepen informacione mbi palën e tretë të ngarkuar me këtë punë.

2.7 DISKRIMINIMI DHE NGACMIMI

Trajtimi i barabartë dhe barazia e shanseve e të gjithë punonjësve duhet të jenë të garantuara gjatë punësimit, shpërblimit, gradimit, masave disiplinore, largimit nga puna, daljes në pension dhe gjatë të gjithë marrëdhënies së punës. Çdo formë e diskriminimit për shkak të moshës, gjinisë, ngjyrës së lëkurës, orientimit seksual, paaftësisë mendore dhe fizike, prejardhjes, kombësisë, racës ose etnisë, grupit social, besimit ose botëkuptimit, mendimit politik, anëtarësisë të një shoqatë punëmarrësish ose të karakteristikave të tjera personale është e ndaluar. Furnitorët duhet të veprojnë në mënyrë aktive kundër diskriminimit dhe ta ndalojë atë.

Ngacmimi seksual ose abuzimi, ofendimet ose intimidimi i punonjësve nuk tolerohen. Sidomos ngacmimet fizike, psikike, seksuale ose verbale dhe gjobat, sulmet, keqtrajtimet dhe intimidimet janë të ndaluara. Meriton të përmendet këtu problemi i

dhunës specifike sipas gjinisë, kryesisht kundrejt grave dhe pakicave seksuale. HUGO BOSS nuk i pranon ngjarje të tilla dhe pret nga furnitorët e tij masa parandaluese për mbrojtjen e këtyre personave. Përveç kësaj duhet të krijohen direktiva, procese dhe masa trajnuese të përshtatshme për punëmarrësit si dhe drejtuesit dhe duhet të ekzistojë një sistem ankimi që mund të aksesohet nga të gjithë.

2.8 KUSHTET E DENJA TË PUNËS

Dinjiteti, privatësia dhe të drejtat personale të të punësuarve duhen respektuar gjithmonë. Ngacmimet fizike, psikike, seksuale ose verbale dhe gjobat, sulmet, keqtrajtimit dhe intimidimet janë të ndaluara. Masat disiplinore janë të lejuara vetëm në kuadrin e përcaktimeve ligjore ose të përcaktimeve të përdorura nga HUGO BOSS dhe duhet të jenë në çdo rast në një raport të përshtatshëm me rastin.

2.9 SHPËRBLIMI I NDESHËM

Të punësuarit posedojnë të drejtën e një shpërblimi të ndershëm, për të mbuluar nevojat e tyre bazë dhe ato të familjeve të tyre dhe që përfitohet gjatë kohës së rregullt javore të punës. Me këtë gjë HUGO BOSS kupton, që mjetet monetare që ndodhen në dispozicion të mjaftojnë, për të siguruar nevojat bazë për ushqim, ujë, banim, arsimim, kujdes shëndetësor, lëvizshmëri dhe veshje për të gjithë pjesëtarët e familjes. Përveç kësaj duhet që punëmarrësi të ketë të ardhura të disponueshme, për të mund të formuar rezerva për ngjarje të papritura. Përveç kësaj të punësuarve i duhet dhënë informacion me shkrim mbi kushtet e dakortësuara në formën e një kontrate pune dhe një fletë-pagese. Furnitorët janë të detyruar, që të paguajnë të paktën pagën minimale ligjore ose, nëse paga është më e lartë, një pagë që është në përputhje me standardin e industrisë. Nëse pagesa e një page më të lartë se një pagë normale në këtë sektor nuk është e mundur për furnitorin, atëherë një gjë e tillë i duhet bërë me dije dhe i duhet arsyetuar HUGO BOSS. Pritet që furnitorët të bashkëpunojnë me HUGO BOSS, për të arritur hap pas hapi një shpërblim të ndershëm. Qëllimi është realizimi i një page që siguron ekzistencën për të gjithë të punësuarit, pavarësisht nga gjinia ose faktorët e tjerë të diversitetit. Përveç kësaj ne presim që të gjithë furnitorët të kenë në vëmendje dhe të respektojnë të gjitha detyrimet kombëtare në fushën e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore.

Përveç kësaj duhet të merren parasysh edhe të gjithë kërkesat ligjore ose kërkesat e tjera në fuqi (p.sh. kontratat kolektive) në lidhje me shërbimet e veçanta. Orët shtesë duhet të shpërblehen me një shtesë, nëse lejohet me ligj, të kompensohen me kohë pushim, nëse punonjësit e miratojnë këtë gjë. Punëmarrëset, të cilat mbetet shtatzënë

gjatë kohës që ato janë në punë, duhet të përfitojnë të gjitha shërbimet dhe siguritë ligjore. Furnitorët e kanë të ndaluar, që të përdorin zbritjet në pagë si masë disiplinore. Nëse ekzistojnë përcaktime kombëtare ligjore, të cilat lejojnë pushimin nga puna të një të punësuarit jo të kushtëzuar nga ndërmarrja, për sa kohë që kundrejt të punësuarit nuk u morën më para masa disiplinore monetare, atëherë të gjitha masat duhet të kryhen vetëm duke marrë parasysh situatën faktike të çështjes. Hapat e procesit duhet të dokumentohen nga furnitori.

2.10 KOHËT E PUNËS

Përcaktimet përkatëse kombëtare të kohëve të punës, duke përfshirë edhe kohët në fuqi të pushimit, përcaktimet e ditëve të festave dhe të pushimit, duhen respektuar. Nëse nuk ekzistojnë përcaktime kombëtare ose nëse këto përcaktime janë nën detyrimet e ILO, atëherë koha e rregullt javore e punës nuk lejohet ti kalojë 48 orë. Duke përfshirë orët shtesë, koha e përgjithshme e punës nuk lejohet ti kalojë 60 orë në një javë. Orët shtesë janë vetëm atëherë të lejuara, nëse punonjësit janë dakord me punën shtesë ose koha shtesë është e rregulluar me ligj ose me kontrata puna kolektive (p.sh. kontratat kolektive), dhe duhet të shpërblehen në përputhje me këtë gjë. Një punëmarrëse, e cila ka arritur muajin e shtatë të shtatzënisë, nuk lejohet as të bëjë orë shtesë dhe as të shkojë në turnin e natës, pavarësisht faktit nëse një gjë e tillë është e lejuar sipas ligjit lokal. Pas gjashtë ditëve pune të njëpasnjëshme duhet që të punësuarit ti akordohet një pushim prej të paktën 24 orësh. Përveç kësaj të punësuarit posedojnë të drejtën e pushimeve minimale ligjore.

2.11 SIGURIA NË PUNË DHE SHËNDETI

Furnitori duhet të garantojë shëndetin dhe sigurinë fizike dhe psikike të të punësuarve në kuadrin e aktivitetit në punë dhe duhet të marrë masa të përshtatshme parandaluese kundër aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.

Sidomos duhet që ndriçimi të jetë i përshtatshëm përgjatë gjithë kohës së punës së aktivitetit të ushtruar, ashtu si edhe emetimi i zhurmave. Ambientet sanitare duhet të jenë të pastra, me sasi të mjaftueshme dhe të ndara sipas gjinive. Të punësuarit duhet që gjatë kohës së punës të kenë akses pa kufizime të papërshtatshme të mjediset sanitare. Nga furnitori duhet garantuar që të jenë krijuar sisteme për përcaktimin, vlerësimin, mënjanimin dhe luftën kundër rreziqeve potenciale për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve. Kërkesat e përmendura këtij i referohen gjithashtu të gjitha mjediseve të tjera si p.sh. banesat, të cilat furnitori i vendos në dispozicion të punësuarve.

Një vëmendje e veçantë i duhet garantuar punëmarrëseve që janë shtatzënë. Ato nuk duhet të përdoren për punë të rënda ose të rrezikshme, përveç kësaj duhet të garantohen pushime të rregullta.

2.12 LIRIA E KOALICIONIT DHE NEGOCIATAT E TARIFAVE

Të gjithë të punësuarit posedojnë të drejtën e lirisë së koalicionit dhe negociatave të tarifave, si dhe të drejtën e themelimit të organizatave sipas zgjedhjes së tyre për qëllime të punës ose për tu bërë anëtar i organizatave të punëmarrësve. Të punësuarit duhet të jenë të lirë që të kryejnë negociata mbi kushtet e punës, sidomos të pagave, dhe ti negociojnë ato sipas dëshirës. Furnitori duhet të njohë dhe të respektojë të drejtën e lirisë së koalicionit dhe të negociatave të tarifave dhe nuk lejohet që punonjësit që e përdorin këtë të drejtë ti diskriminojë, ngacmojë, intimidojë, heqë nga puna ose ti trajtojë ato në një mënyrë tjetër në dëm të tyre.

3. ASPEKTET E MJEDISIT

HUGO BOSS i nxit furnitorët e tij, që të punojnë vazhdimisht në reduktimin e ndotjes së mjedisit, që krijohet nga aktiviteti përkatës i biznesit. Duhet që të respektohen të paktën ligjet dhe përcaktimet për mbrojtjen e mjedisit të vendit prodhues. Resurset natyrore duhet të përdoren në mënyrë sa më të qëndrueshme dhe efikase të jetë e mundur. Gjatë këtyre proceseve mbrojtja e njeriut, kafshëve dhe mjedisit është kryesorja. Furnitorët nxiten që të krijojnë një sistem për menaxhimin e mjedisit, që kontribuon me objektiva konkrete për rritjen e përgjegjësisë për mjedisin.

3.1 KONSUMI I ENERGJISË DHE EMETIMET E GAZIT SERRË

Furnitorët janë të detyruar, që të identifikojnë dhe monitorojnë të gjitha burimet e rëndësishme të energjisë dhe emetimet e gazit serrë. Krijimi i një programi për reduktimin e konsumit të energjisë si dhe për reduktimin e emetimeve duhet synuar. HUGO BOSS pret nga furnitorët e tij, që ato të zotohen që të nxisin vazhdimisht masat për përdorimin me efikasitet të energjisë si dhe përdorimin e energjive të rinovueshme.

3.2 KONSUMI I UJIT

Konsumi i ujit duhet të monitorohet nga furnitorët dhe duhet të optimizohet me strategji të përshtatshme. Marrja e ujit nga ujërat sipërfaqësore ose ujërat nëntokësore duhet të jenë të paktën në përputhje me kërkesat kombëtare ose lokale. Sidomos furnitorëve me procese prodhimi, të cilët sjellin me vete një përdorim intensiv të ujit, ju kërkohet që ta minimizojnë vazhdimisht përdorimin e ujit.

3.3 MENAXHIMI I KIMIKATEVE DHE MENAXHIMI I UJËRAVE TË ZEZA

Nëse proceset e prodhimit kushtëzojnë përdorimin e kimikateve ose lëndëve të tjera, të cilat paraqesin një rrezik për njerëzit, kafshët dhe mjedisin, atëherë furnitorët duhet të garantojnë, që përdorimi dhe trajtimi si dhe magazinimi dhe transporti të jenë të rregulluara nga një menaxhim i lëndëve të rrezikshme. Përcaktimet ligjore duhen respektuar. Nëse ekzistojnë lëndë alternativë, të cilat janë më pak të dëmshme si për mjedisin ashtu edhe për shëndetin, atëherë furnitorët nxiten, që ti përdorin ato. Përdorimi i kimikateve dhe i lëndëve të tjera e detyron furnitorin, që të kontrollojë qarkullimin e ujërave të zeza dhe të identifikojë ndotje të mundshme. Kjo gjë duhet të kryhet në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse. Kontrollat duhet të kryhen rregullisht.

3.4 MENAXHIMI I MBETEJEVE

HUGO BOSS i nxit furnitorët e tij, që ti minimizojnë vazhdimisht mbetjet dhe ti trajtojnë mbetjet e krijuara në përputhje me detyrimet ligjore vendore. Marrja parasysh e strategjive për evitimin ose reduktimin e mbetjeve dhe riciklimin pritet nga furnitorët.

3.5 PAKETA TË TJERA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Në varësi të vendndodhjes dhe proceseve specifike të prodhimit të partnerit, mund të aplikohen sidomos, përveç aspekteve për mbrojtjen e mjedisit të listuara me saktësi më sipër edhe përcaktime kombëtare dhe lokale për emetimet në ajër, për përdorimin e sipërfaqes, për mbrojtjen e biodiversitetit, për ndotjen nga zhurmat ose aromat dhe të aspekteve të tjera për mbrojtjen e mjedisit.

4. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT JO QEVERITARE

Për të përmirësuar kushtet sociale dhe nevojat për mbrojtjen e mjedisit në lidhje me bashkëpunimin me furnitorët, HUGO BOSS bashkëpunon me organizata të ndryshme jo qeveritare. Në kuadrin e një partneriteti të tillë HUGO BOSS rezervon të drejtën, që të transferojë të drejtën e pretenduar në fillim për kontrole të mundshme (p.sh. audite) te këto organizata partnere.

5. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

HUGO BOSS pret nga furnitorët e tij respektimin e standardeve të vendosura këtu, të cilat respektohen nga vetë HUGO BOSS, dhe i nxit partnerët e tij, që të mbështesin sa më shumë implementimin përmes mjeteve të përshtatshme ndihmëse si sistemet e

menaxhimit, direktivat, trajnimet dhe specifikimet e proceseve. Të gjithë punonjësit e furnitorëve duhet të trajnohen mjaftueshëm dhe rregullisht në lidhje me temat e përmendura këtu. Përveç kësaj furnitorët nga ana e tyre janë të detyruar, që t'ia transferojnë këto detyrime para-furnitorëve të tyre dhe partnerëve dhe të kontrollojnë në mënyrë të përshtatshme respektimin e tyre. HUGO BOSS rezervon të drejtën, që të kontrollojë ose të përshtatë kodin e sjelljes së furnitorëve rregullisht, por të paktën një herë në vit dhe ta kontrollojë atë nëse është aktual duke përfshirë grupet e rëndësishme të interesit, dhe ti komunikojë furnitorëve ndryshimet.

Shkurt 2022

Versioni 2.0

Versioni 2.0

SHTOJCA:

INFORMACIONET PËR PËRDORIMIN E SISTEMEVE PËR DHËNIEN E INDIKACIONEVE TË HUGO BOSS

Punonjësit e HUGO BOSS, të partnerëve vetjak dhe të furnitorëve, por edhe klientëve dhe klienteve të ndërmarrjes dhe palë të tjera të treta kanë mundësinë, që në rast pyetjesh dhe ankesash në lidhje me standardet sociale, kushtet e punës ose të drejtat e njeriut, ti drejtohen direkt HUGO BOSS ose avokatit të HUGO BOSS.

HUGO BOSS ofron një kanal ankimi, përmes të cilit mund të dorëzohen indikacione dhe ankesa në mënyre sekrete dhe anonime. Ai mund të përdoret në shumë gjuhë nëpërmjet linkut të mëposhtëm:

[HUGO BOSS Whistleblowing Portal](#)

Me të drejta të barabarta dhe si opsion tjetër – edhe për kontaktin personal – ndodhet në dispozicion avokati i HUGO BOSS si pikë kontakti për çështje ekonomike, shkelje të të drejtave të njeriut si dhe shkelje të kodit të sjelljes së furnitorëve të HUGO BOSS.

Avokati i HUGO BOSS mund të arrihet si më poshtë:

Dr. Carsten Thiel von Herff
Avokat i jashtëm
Telefon: + 49 521 55 7 333 0
Celular: + 49 151 58 23 03 21
E-Mail: ombudsmann@thielvonherff.com
Thiel von Herff Rechtsanwälte
Loebellstraße
4, 33602 Bielefeld
Gjermani

Të gjitha indikacionet trajtohen me fshehtësi të rreptë. Identiteti i personit që jep indikacionin dhe të gjithë personat e përmendur të cilët janë objekt i raportimit, i bëhen me dije vetëm personave, të cilët janë përgjegjës për marrjen e raportimeve ose për marrjen e masave të mëposhtme, për sa kohë nuk ekzistojnë përgjashtime ligjore.

Represaliet që i drejtohen atyre që japin indikacionet janë të ndaluara. Kjo vlen edhe për kërcënimin dhe përpjekjen, për ta kryer represalien.

Avokati i HUGO BOSS mund të kontaktohet në çdo kohë falas edhe në numrat ndërkombëtar të listuar më poshtë. Pengesat eventuale të gjuhës tejkalohen duke pajtuar nëse është e nevojshme përkthyes profesional.

Egjipt:	00800 00 09 571
Belgjikë:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Brazil:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Bosnje-Hercegovinë:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Bullgari:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Danimarkë:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Gjermani:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Francë:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Greqi:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Britani e Madhe:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Indi:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Indonezi:	001 803 49 32 86
Irlandë:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Itali:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Kroaci:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Malajzi:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Maqedoni:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Meksikë:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Holandë:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Austri:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Poloni:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Portugali:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Rumani:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Serbi:	0800 19 10 46
Zvicër:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Spanjë:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Kore e Jugut:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Tajvan:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Tajlandë:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Turqi:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
Ukrainë:	00800 50 47 10
Hungari:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN
SHBA:	00800 66 28 37 626 / 00800 OMBUDSMAN

Në Kinë, Hong Kong Sri Lanka, Bangladesh, Laos dhe Vietnam HUGO BOSS ka krijuar gjithashtu numra vetjak telefoni për te personat e besueshëm të HUGO BOSS (jo te avokati i HUGO BOSS), të cilët marrin në çdo moment indikacione ose ankesa mbi shkeljet.

Kinë:	0086 1350 0009 061
Hong Kong:	0086 1350 0009 061
Sri Lanka:	0086 1350 0009 061
Bangladesh:	0086 1350 0009 061
Laos:	0086 1350 0009 061
Vietnam:	0086 1350 0009 061

Gjithashtu punonjësit e furnitorëve të HUGO BOSS mund të zgjedhin vetë të kontaktojnë direkt HUGO BOSS:

Vendor_Sustainability@hugoboss.com

Shkurt 2022